



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:099345

Datë: 14.02.2025

Numri i dokumentit: 06850320

P.nr.1829/23

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, në përbërje prej gjyqtares së vetme gjykues Valbonë Fejza dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonard Gashi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.K. nga Prishtina, për shkak të veprës penale - Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësitë e trafikut publik nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.507/23 të datës 28.04.2023, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor, sipas aktakuzës së lartcekur, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor me datë 12.02.2025, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.507/23 të datës 28.04.2023, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPRK-së jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

B.K., nga babai B. dhe nëna Sh., i lindur më ....., me nr. personal .... me vendbanim në rr. “....” në Prishtinë, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datën ....., rreth orës 05:30, në rr. “....” në afërsi të Shkollës së Mesme “Gjin Gazuli” në Prishtinë, derisa i pandehur B.K., ishte duke drejtuar automjetin e tipit “...”, me ngjyrë të zezë, me targa të regjistrimit ....., nga drejtimi Gërmisë, në drejtim të qendrës së Prishtinës nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën e njeriut, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 120 par. 1 të ligjit për siguri në komunikacionin rrugor, ashtu nuk e ka mbajtur distancën e sigurisë në mes veturave, ashtu që si pasojë në pjesën e pasme e godet automjetin e tipit “...”, me ngjyrë të verdhë, me targa të regjistrimit ....., të cilin e drejtonte N.B, dhe si pasojë e goditjes i njëjti kishte pësuar lëndime të lehta trupore, kurse i pandehuri ishte larguar nga vendi i ngjarjes.

- me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale - Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësitë e trafikut publik nga neni 374 par. 1 të KPK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 38, 39, 40, 43,61, dhe 69 të KPRK-ës, si dhe bazuar në nenet 365, 493, 495 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I. Në lartësi prej 300 € (treqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej 3 muaj prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.
- II. Në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.
- III. I dëmtuari N.B., me vendbanim në Prishtinë, rr.”....” p.nr., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.
- IV. OBLIGOHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

## ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.507/23 të datës 28.04.2023, kundër të pandehurit B.K. për shkak të veprës penale Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësitë e trafikut publik nga neni 374 par. 1.

Së bashku me aktakuzën prokuroria ka dorëzuar kërkesën me të cilën ka kërkuar që të pandehurit B.K. t'i shqiptohet urdhri ndëshkimor- dënim me gjobë.

I pandehuri është i akuzuar për veprën penale Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësitë e trafikut publik nga neni 374 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), që e ka këtë përshkrim: Ngasësi i automjetit ose i mjetit tjetër të transportit, i cili nuk i ofron ndihmë personit të lënduar me atë mjet të transportit, dënohet me burgim deri në një (1) vit.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet nga neni 493 par.1 dhe 495 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ashtu që vendosi ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: mendimi i ekspertit, mjeko-ligjor Dr. F.B. i dt. ..., mendimi i ekspertit të komunikacionit Inxh. L.K. i dt. ...., janë prova që ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe se i pandehuri ka kryer veprën penale Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësitë e trafikut publik nga neni 374 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, gjykata u mbështet në nenin 43 par.1 dhe 2, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), ku nga provat e bashkangjitura lëndës dhe faktet e përshkruara si në aktakuzë gjykata erdhi në përfundim se dënimi me gjobë i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrij qëllimin e dënimit siç parashihet në nenin 38 të KPPRK-së dhe se ky dënim do të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të

ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar që kërkesën pasurore-juridike ta realizoj në kontest civil gjykata e mori në kuptim të nenit 462 par.1 dhe par.2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor është marrë në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga se u tha më lartë, në kuptim të neneve 364 dhe 495 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal  
P.nr.1829/23, me datë 12.02.2025

Gjyqtare e vetme gjykuese  
Valbonë Fejza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.

Vërejtje: Nëse nuk paraqitet kundërshtimi brenda afatit të lartshënuar, urdhri ndëshkimor merr formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar të pandehurit ekzekutohet.